



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 737/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.11.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-30190-07-12-2019, me objekt: “Blerje materiale mjekësore specifike për Shërbimin e Hemodinamikës në QSUT” Loti 5 “Pacemaker MRI compatible/Pacemaker të përshtatshëm për MRI”, me fond limit 8.843.138,34 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.”

Ankimues: “Biometric Albania” sh.p.k.
Rruga “Vllazën Huta”, Pallati i Ri “Vila Park”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

Subjekte të interesuar: “O.E.S Distrimed” sh.p.k.
Bulevardi “Bajram Curri”, Pallati “Kastrati”, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.

914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.07.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-30190-07-12-2019, me objekt: “Blerje materiale mjekësore specifike për Shërbimin e Hemodinamikës në QSUT” Loti 5 “Pacemaker MRI compatible/Pacemaker të përshtatshëm për MRI”, me fond limit 8.843.138,34 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 20.08.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--------------------------------|-----------------------------------|
| 1. “O.E.S Distrimed” sh.p.k. | 5.650.000 lekë, kualifikuar |
| 2. “Biometric Albania” sh.p.k. | 6.069.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Iris” sh.p.k. | 6.119.300 lekë, skualifikuar |
| 4. “Montal” sh.p.k. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 16.09.2019 operatori ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 23.09.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

[...] Bazuar në LPP, neni 63 pika 2, kontestojme vendimin e KVO për kualifikimin e ofertës së OE OES Distrimed, pasi produktet e ofruara nuk plotësojnë specifikimet teknike të kerkuara në DST. Në tabelën e mëposhtme janë specifikimet teknike të kerkuara për LOT 5

	<i>Pacemaker MRI kompatibel (Pacemaker të pershtateshem per MRI)</i>		
<i>I*</i>	<i>VVIR - FULL BODY MRI 1.5T pacemaker, storage of intracardiac electrograms, ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity, ëith programmable pacing polarity (unipolar and bipolar), impedance trend (graph of daily measured lead impedance vs. time), and automatic pacing polarity sëitch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead impedance is out of programmable range including bipolar lead, longevity of more than 14 years ëith 60 stimulations in minute at 2.5V 100% stimulation 0,4ms pulse ëidth.Compatible pacing lead ëith active or passive fixation ëith minimum introducer of 7F.Sheeth-introducer peel aëay for introducing permanent pacemaker electrode (including guide ëire, syringe, dilator, needle and introducer)of standard size from minimum 7 F. VVIR - stimulues kardiak , MRI kompatibel, full body 1.5T, ruajtja e elektrogrameve intrakardiake, me kalimin automatik të parametrave të tjerë në bazë të aktivitetit të pacientit, me programim të polaritetit të pejsimit (unipolar dhe bipolar), impedancën trendi (grafik i matjes së matjes së pjesshme të impedances ndaj kohës) dhe kalimi i polaritetit automatik të pejsimit nga bipolar në unipolar pacing në rast se impedanca e matur e plumbit është jashtë diapazonit të programueshëm duke përfshirë sonden bipolar, jetëgjatësinë e më shumë se 14 vjet me 60 stimulime në minutë në 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls.Sonda me Pejsim kompatibel me fiksime aktive ose</i>	<i>cope</i>	<i>25</i>

	<i>pasive me hyrjen minimale të 7F. Sheath-peel aëëaypër futjen e elektrodës e pacemakerit (duke përfshirë tela udhëzues, shiringë, dilator, gjilpërë dhe futës) të madhësisë standarde nga minimumi 7F.</i>		
2*	<i>A fib FULL BODY MRI 1.5T dual chamber pacemaker, storage of intracardiac electrograms, ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity, automatic pacing polarity sëitch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead impedance is out of programmable range including bipolar lead, Algorithm for suppression atrial fibrillation by atrial pacing in sinus rhythm, automatic algorithm to prevent unnecessary ventricular stimulation by adapting the AV delay, special frequency stimulation during mode changes (mode sëitch), storage of intracardiac electrograms in the device memory for 2 minutes ëith choice of priorities triggers, NIPS protocol, PVC Response, algorithm for terminating a PMT , longevity of more than 9 years ëith 60 stimulations in minute at 2.5V 100% stimulation 0,4ms pulse ëidth ëith Stored EGM On. Compatible atriala and pacing lead ëith active or passive fixation ëith minimum introducer of 7F. DDDR stimulues kardual FULL BODY MRI 1.5T, stimulues me dy dhoma, ruajtja e elektrogrameve intrakardiacale, me kalimin automatik të parametrave të tjerë në bazë të aktivitetit të pacientit, kalimi automatik i pacing polaritetit nga bipolar në pacing unipolar në rast se impedanca e matur e plumbit është jashtë diapazonit të programueshëm duke përfshirë sonden bipolar, Algoritmi për fibrilimin atrial të shtypjes nga pacing atrial në ritmin e sinusit, algoritmi automatik për të parandaluar stimulimin e panevojshëm ventrikular duke përshtatur vonesën AV, stimulim të veçantë të frekuencës gjatë ndryshimeve të modalitetit (kaloni mode) , ruajtjen e electrograms intracardiac në kujtesën e pajisjes për 2 minuta me zgjedhjen e prioriteteve shkaktton, NIPS protokoll, PVC Përgjigje, algorithm për ndërprerjen e një PMT, jetëgjatësi më shumë se 9 vjet me 60 stimulime në minutë me 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls me EGM të ruajtura On. Compatibl e atriale dhe pacing plumbi me fiksion aktiv ose pasiv me hyrjen minimale të 7F</i>	<i>cope</i>	<i>15</i>

Duke qene se OE OES Distrimed eshte distributor eskluziv i firmes Vitatron (Medtronic) bazuar edhe ne eksperiencen e viteve te shkuara per kete procedure prokurimi, kemi shqyrtuar produktet respektive qe prodhon firma Vitatron (Medtronic) te pershtatshem per MRI. Rezulton se kjo firme prodhon per VVIR- FULL BODY MRI 1.5T dy modele G20SR SureScan dhe Q20SR SureScan, Surescan Models. Bazuar ne specifikimet teknik ne DST per artikullin 1. VVIR-FULL BODY MRI 1.5T eshte kerkuar jetegjatesine e me shumate se 14 vjet me 60 stimulime ne minute ne 2.5V stimulim 100% 0.4ms gjerësi impuls (Longevity of more than 14 years ëith 60 stimulations minute at 2.5V 100% stimulation 0.4ms pulse ëidth). Pra eshte kerkuar qe jetegjatesia e ketij pacemaker te jete jo me pak se 14 vjet, per frekuencen qartesishite te kerkuar 60 stimulime ne minut, ne 2.5 V, stimulim 100% dhe 0.4 ms gjerësi impulse.

Pas verifikimit të modeleve të prodhuara nga Vitatron (apo të çdo modeli tjetër të Medtronic) rezulton që për të dy modelet (shih katalogun shoqëror).

1. G20SR Jetëgjatësia është 10.4 vjet për frekuencën 60 stimulime/min, 100% stimulim, 2.0V0.4 ms

2. Q20SR Jetëgjatësia është 9,6 vjet për frekuencën 60 stimulime/min, 100% stimulim, 2.0V0.4 ms
Sa më sipër konfirmohet se jetëgjatësia maksimale e ofruara për këto modele, për frekuencën e kërkuar (60 stimulime në minut, në 2.5 V, stimulim 100% dhe 0.4 ms gjëresi impulse) është jo më shumë se 10.4 vjet. Për del qarte që asnjë nga modelet e ofruara nuk plotëson specifikimet teknik të kërkuara, por ka një diferencë të dukshme teknik 4 vjet më pak (ose 40% më të ulët që specifikimet teknik të kërkuara. Ky devijim është devijim thelbësor, i cili ka efekt të dukshëm ekonomik, pasi një pacemaker i tillë do të zëvendësohet 4 vjet më parë se ai i kërkuar në DST, pra rezulton në efektin kohë rreth 40 % më i shtrenjtë.

I njëjti arsyesim qëndron edhe për modelet e tjera të Azure XT SR MRI, Astra M XT SR Ensura MRIM të Medtronic. Asnjëra prej modeleve nuk kalon 12.5 vjet kundrejt jo më pak se 14 vjet të kërkuara në DST, verifikim teknik i jetëgjatësisë së dajisies. duhet të behet për frekuencën e kërkuar në DST. Çdo verifikim teknik i jetëgjatësisë së pajisjes, duhet të bëhet për frekuencën e kërkuar në DST (60 stimulime në minut, në 2.5 V, stimulim 100% dhe 0.4 ms gjëresi impulse), në të kundërt bie ndesh me LPP.

Deklarojmë se vendimi i KVO që konsideron të vlefshme ofertën ekonomike të OE OES është bërë në kundërshtim me LPP nën 1 dhe 2 [...].

Bazuar në nenin 53 të LPP, Neni 3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në të gjitha kërkesat specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për duket qarte që vendimi i KVO është marrë në kundërshtim me LPP, duke favorizuar padrejtësisht një OE duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik, pjesëmarrës në këtë procedurë. Kërkojmë të vlerësohet e pavlefshme oferta e OE OES Distrimed, për Lotin 5.

2. Në DST është specifikuar për atikullin 1 dhe 2 si më poshtë:

me kalimin automatik të parametrave të tjera në bazë të aktivitetit të pacientit (ëithë automatic switching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity).

Pas konsultimit me ekspertët nderkombëtar që kanë ndihmuar në përpilimin e ofertës ekonomike dhe teknike të OE BIOMETRIC ALBANIA, në rezulton se asnjë nga modelet e prodhuara nga Vitatron (Medtronic) nuk plotëson këto specifikime teknik të kërkuar. Nga sa më sipër rezulton se vendimi i kvo është bërë në kundërshtim me LPP nën 53, pasi është vlerësuar si e vlefshme një ofertë e cila dukshëm nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Lutem AK, të shqyrtoje dhe vlerësoje argumentet teknik të paraqitura nga BIOMETRIC ALBANIA, të skualifikojë ofertën e OES Distrimed si ofertë me devijime të dukshme teknike.

Oferta e OE BIOMETRIC ALBANIA bazuar në nenin 55 të LPP, është oferta ekonomikisht më e favorshme.

II.5. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, me shkresën nr. 3281/9 prot., datë 10.10.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar

ankesën. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pretendon se nuk ka marrë dëgjim në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor. Konkretisht, në shkresën nr. 3281/9 prot., datë 10.10.2019, autoriteti kontraktor ka argumentuar se:

[...] KSHA në përfundim të vleresimit të dokumentacionit tekniko – ligjore në dispozicion, arriti në konkluzionin që: Kryetari i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), arriti në konkluzionin si më poshtë:

Në lidhje me ankesën për piken 1, sipas DST për Lotin 5:

	<i>Pacemaker MRI kompatibel (Pacemaker të pershtateshem per MRI)</i>		
1*	<i>VVIR - FULL BODY MRI 1.5T pacemaker, storage of intracardiac electrograms, ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity, ëith programmable pacing polarity (unipolar and bipolar), impedance trend (graph of daily measured lead impedance vs. time), and automatic pacing polarity sëitch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead impedance is out of programmable range including bipolar lead, longevity of more than 14 years ëith 60 stimulations in minute at 2.5V 100% stimulation 0,4ms pulse ëidth.Compatible pacing lead ëith active or passive fixation ëith minimum introducer of 7F.Sheeth-introducer peel aëay for introducing permanent pacemaker electrode (including guide ëire, syringe, dilator, needle and introducer)of standard size from minimum 7 F. VVIR - stimulues kardiak , MRI kompatibel, full body 1.5T, ruajtja e elektrogrameve intrakardiake, me kalimin automatik të parametrave të tjerë në bazë të aktivitetit të pacientit, me programim të polaritetit të pejsimit (unipolar dhe bipolar), impedancën trendi (grafik i matjes së matjes së pjesshme të impedances ndaj kohës) dhe kalimi i polaritetit automatik të pejsimit nga bipolar në unipolar pacing në rast se impedanca e matur e plumbit është jashtë diapazonit të programueshëm duke përfshirë sonden bipolar, jetëgjatësinë e më shumë se 14 vjet me 60 stimulime në minutë në 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls.Sonda me Pejsim kompatibël me fiksim aktive ose pasive me hyrjen minimale të 7F.Sheath-peel aëëaypër futjen e elektrodës e pacemakerit (duke përfshirë tela udhëzues, shiringë, dilator, gjilpërë dhe futës) të madhësisë standarde nga minimumi 7F.</i>	cope	25
2*	<i>A fib FULL BODY MRI 1.5T dual chamber pacemaker, storage of intracardiac electrograms, ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity, automatic pacing polarity sëitch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead impedance is out of programmable range including bipolar lead, Algorithm for suppression atrial fibrillation by atrial pacing in sinus rhythm, automatic algorithm to prevent unnecessary ventricular stimulation by adapting the AV delay, special frequency stimulation during mode changes (mode sëitch), storage of intracardiac electrograms in the device memory for 2 minutes ëith choice of priorities triggers, NIPS protocol, PVC Response,</i>	cope	15

	<p>algorithm for terminating a PMT , longevity of more than 9 years ëith 60 stimulations in minute at 2.5V 100% stimulation 0,4ms pulse ëidh ëith Stored EGM On.Compatible atriala and pacing lead ëith active or passive fixation ëith minimum introducer of 7F.DDDR stimulues karduak FULL BODY MRI 1.5T, stimulues me dy dhoma, ruajtja e elektrogrameve intrakardiacale, me kalimin automatik të parametrave të tjerë në bazë të aktivitetit të pacientit, kalimi automatik i pacing polaritetit nga bipolar në pacing unipolar në rast se impedanca e matur e plumbit është jashtë diapazonit të programueshëm duke përfshirë sonden bipolar, Algoritmi për fibrilimin atrial të shtypjes nga pacing atrial në ritmin e sinusit, algoritmi automatik për të parandaluar stimulimin e panevojshëm ventrikular duke përshtatur vonesën AV, stimulim të veçantë të frekuencës gjatë ndryshimeve të modalitetit (kaloni mode) , ruajtjen e electrograms intracardiac në kujtesën e pajisjes për 2 minuta me zgjedhjen e prioriteteve shkaktton, NIPS protokoll, PVC Përgjigje, algorithm për ndërprerjen e një PMT, jetëgjatësi më shumë se 9 vjet me 60 stimulime në minutë me 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls me EGM të ruajtura On.Compatibl e atriale dhe pacing plumbi me fiksion aktiv ose pasiv me hyrjen minimale të 7F</p>		
--	--	--	--

Nga dokumentacioni që administrohet në SPE, rezulton se Operatori Ekonomik "OES DISTRIMED" shpk, ka ofertur aparatën Medtronik/Vitatron G202, që janë në faqe nr. 2 të katalogut origjinal të markuar. Sipas këtij katalogu në faqen 2 të tij (katalogët origjinale të markuar), është nenvizuar jetëgjatësia 9.6 vite. [...]

Per kete arsye si dhe nisur nga fakti që vete dokumentacioni i administruar nga OE tregon jetëgjatësinë, operatori "OES DISTRIMED" shpk nuk ka permbushur kriteret e kerkuar per sa i perket jetëgjatësisë së aparatit dhe per kete arsye ky operator nuk e permbush kerkesen e bere ne DST nga AK. Pra pretendimi i ngritur nga ankuesi per pretendimin e paraqitur ne piken 1 qendron. Per sa i perket pretendimit nr. 1, anetaret e tjere te KSHA, pasi vleresuan te gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor te administruar, si dhe PV e mbajtur nga KVO ku kjo e fundit ne zbatim te parashikimeve te LPP dhe RrPP ka vleresuar se: Gjate shayrtimit te dokumentacionit te OE "OES DISTRIMED" KvO per plotesimin e kriterit "jetëgjatësia 14 vjet me stimulime (60) ne minute ne 2.5V stimuli 100%, 0.4ms gjerësi impuls", dha argumentin si me poshte: Jetëgjatësia është element që varet drejtpërdrejte nga impendaca ku impedanca është Rezistenca e rrymes që transmetohet në elektroda. Ne DST nuk është parashikuar vlera që duhet të kete Impedanca. Meqenese vleresimet e jetëgjatësisë rriten/ulen ne menyre lineare bazuar ne parametra te tille si impedanca e Lead-it, dhe amplitude atriale ose ventikulare behet nje shpjegim si me poshte: Nese jetëgjatësia e pajisjes është e barabarte me 8.7 vjet per nje amplitude A/V prej 2.5 V me një ritëm pejsimi te programuar prej 60 min behet llogaritja e meposhtme: (faqe nr 29, 33-34 e- Katalogut Original).

Pejsimi	Amplituda A V	Ritmi, Gjerësia e pulsit	Impedanca e Lead-it	
			500Ω	1000Ω
			Jetëgjatësia (vite)	

SSIR ose SSI, 100%	2.0 V	60 min-1, 0.4 ms	9.6	10.4
	2.5 V		8.7	9.5
	3.5 V		7.5	8.9

Jetegjatesia e pajisjes rritet me te pakten 9.2 % per cdo ndryshim me 500Ω ne impedance. Bazuar ne kete vlere mund te behet ekstrapolimi (llogaritja e meposhtme).

Impedanca	1500Ω	2000Ω	2500Ω	3000Ω	3500Ω
Jetegjatesia	10.4 vite	11.3 vite	12.4 vite	13.5 vite	14.7 vite

Në reference te katalogut original te paraqitur ne SPP (manuali I pajisjes per Vitatron G20 SR MRI SureScan, Model G20A2) modeli per te cilin ka ofertuar OE OES.DISTRIMED” faqe 29-30 Tabela Nr.11 Arterial Lead dhe Tabela 12 Ventikular Lead jepen te dhena per vleren e Impedances e cila shkon në 4000Ω. Pra si rezultat i llogaritjes se mesiperme per vleren e Impedances 3500 Ω jetegjatesia e pajisjes arrin ne 14.7 vite, nderkohe qe ne manualin e pajisjes vlere e Impedances shkon ne 4000Ω rrjedhimisht jetegjatesia do te rritet me shume se 14.7 vite, duke plotesuar ne kete menyre kriterin e vendosur ne DST per jetegjatesine e pajisjes.

Ne keto kushte Komisioni i Vleresimit te Ofertave unanimitisht giikon qe kriteri "jetegjatesia 14 vjet me stimulime (60) ne minute ne 2.5V stimuli%, 0.4 ms gjeresi impuls, plotesohet nga OE "OES DISTRIMED", pavaresisht faktit qe nuk eshte shpehur me menyre te drejte-perdrejte Jetegjatesia e pajisjes. Per sa me siper dhe bazuar ne LPP, ne Neni 53, pika 4:autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristika, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigojohen pa prekur permbajtjen e saj, Komisioni i Vleresimit te Ofertave e konsideroje si devijim i vogel, duke e vleresuar oferten e paraqitur nga OE ofertues "OES DISTRIMED" si oferte te vlefshme per proceduren "Blerje materiale mjekesore specifike per Sherbimin e Hemodinamikes ne QSUT" per vitin 2019-2020" Loti 5: Pacemaker MRI compatible/Pacemaker te pershtatshem per MRI.

Per, kete arsye, si dhe nisur nga fakti qe sipas argumentimit te mesiperme, si dhe referuar parashikimit te bere ne nenin 53, pika 4 e LPP, per aq sa pajisja e ofruar nuk e cenon thelbin e permbushjes se kontrates si dhe eshte ne perputhje me parashikimet ligjore, te dy anetaret e KSHA vleresojne se pretendimi i ngritur nga OE Biometric Albania per piken 1 nuk qendron.

Per sa i perket pretendimit nr 2 te ngritur nga OE ankimues:

Kryetari i KSHA, arriti ne konkluzionin si me poshte:

Ne lidhje me ankesen per piken 2: Gjithashtu operatori "OES DISTRIMED" ShPK ne modelet e ofruara nuk ka specifikim "ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity", për këtë arsye vlerësoj se ky operator nuk e plotëson kriterin e kërkuar ne DST për: kalimin automatik të parametrave te tjere ne baze te aktivitetit te pacientit (sleep rest). Pra per pretendimi i ngritur nga ankuesi per piken 2 qendron.

Per sa i perket pretendimit nr. 1, anetaret e tjere te KSHA, pasi vleresuan te gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor te administruar, arriten ne konkluzionin se: Per sa i perket karakteristikes se kerkuarte pajisjes: ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity (me kalimin automatik te parametrave te tjere ne baze te aktivitetit te

pacientit) se pari sqarojme se e gjithë procedura e shpallur e prokurimit, sipas percaktimeve të DST ku citohet se:

4.6. Gjuha (-et) per hartimin e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje:

Shqip X Anglisht ___
Tjeter _____

Si dhe

Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentat ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohen me nje perkthim te noterizuar ne gjuhen shqipe.

Pra gjuha e perdorur ne kete procedure eshte gjuha shqipe, dhe ne kete aspekt prevalon parashikimi i bere ne DST ne gjuhen shqipe ku per karakteristiken per te cilin ankohet OE citohet: kalimin automatik te parametrave te tjere ne baze te aktivitetit te pacientit, dhe ne gjuhen angleze "ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity.

Sqarojme se parashikimi i karakteristikave edhe ne gjuhen angleze behet me qellim qe OE te orientohen per natyren e specifikimit te kerkuar, por per aq kohe sa procedura shpallet ne gjuhen shqipe, cdo OE ofertues eshte i detyruar ti permbahet kerkesave te bera ne gjuhen shqipe dhe ne kerkesen e bere ne gjuhen shqipe ne DST specifikon kalimin automatik te parametrave te tjere ne baze te aktivitetit te pacientit, specifike te cilen OE, nepermjet dokumentacionit te administruar rezulton se e ploteson. Gjithashtu KSHA, ne kuader te frymes se transparences te cilen legjislatori e synon nepermjet legjislacionit te prokurimit publik dhe akteve nenligjore per zbatim te tij, gjate hetimit administrativ te iniciuar nepermjet Formularit tij ankeses me nr. 3281/1 prot, date 23.09.2019, konstatoi se ne Kataloget e paraqitur nga OE "OES Distrimed" sh.p.k, per artikujt e ofruar paraqiten te dhenat: Sleep Function: (Sleep Function - This programmable feature suspends the programmed Loëer Rate and replaces it ëith a Sleep Rate during a specified sleep period), e cila pasi aplikohet pajisja te pacienti, programohen parametrat e gjumit dhe kyfksion ben rregullimin automatik nga rrahjet e uleta tek rrahjet optimale te gjumit dhe nga rrahjet e uleta ne rrahjet e larta kur pacienti eshte zgjuar apo kur aktiviteti i pacientit eshte i larte, bazuar kjo ne veprimtarine e pacientit. Ne katalogun "Kataloget origjinale te markuar Loti 5" sqarohet ne piken 7.10 e vijues (faqe 181). Per sa i perket kalimit automatik te parametrave te tjere ne baze te aktivitetit te pacientit, ne katalogun e administruar parashikohet qartesisht se paisja mjekesore e ofruar i ka funksionet automatike te kerkuara, per kete arsye dhe sa me siper, vleresojme se pretendimi i ngritur nga OE ankimues per kete pike (piken 2), nuk qendron. Në këtë kuadër dhe për sa është argumentuar më sipër, si dhe KSHA në respektim të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit nr.9643 dt 20.11.2006 "Per prokurimin publik", të ndryshuar dhe VKM nr.914/2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar, KSHA me shumice votash ka arritur ne konkluzionin: Te mos pranoje pretendimet e ngritura nga OE "Biometric Albania" sh.p.k. ne ankesën e administruar prane AK QSU "Nene Tereza", me nr.3281/1 prot., date 23.09.2019, si e pabazuar ne ligj dhe prova.

II.6. Në datën 09.10.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 21.10.2019, nëpërmjet shkresës me nr.3281/11 prot., datë 16.10.2019, me objekt: “Informacion sqarues në lidhje me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.1600/1 Prot., datë 11.10.2019, administruar në QSUNT me nr. 3281/10 prot., datë 14.10.2019, për një nga lotet e procedurës kryesore me objekt: “Blerje materiale mjekësore specifike për Shërbimin e Hemodinamikës në QSU”, e ndarë në lote, me nr. REF-30176-07-12-2019, konkretisht Loti 5-Pacemaker MRI compatible/Pacemaker të përshtatshëm për MRI, me REF-30190-07-12-2019”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k. me arsyetimin se [...]Bazuar ne specifikimet teknik ne DST per artikullin 1. VVIR-FULL BODY MRI 1.5T eshte kerkuar jetegjatesine e me shuma se 14 vjet me 60 stimulime ne minute ne 2.5V stimulin 100% 0.4ms gjeresi impuls (Longevity of more than 14 vears ëith 60 stimulations minute at 2.5V 100% stimulation 0.4ms pulse ëidth). Pra eshte kerkuar qe jetegjatesia e ketij pacemaker te jete jo me pak se 14 vjet, per frekuencen qartesishte te kerkuar 60 stimulime ne minut, ne 2.5 V, stimulin 100% dhe 0.4 ms gjeresi impulse. Pas verifikimit te modele te prodhuara nga Vitatron (apo te cdo modeli tjeter te Medtronic) rezulton qe per te dy modelet (shih kataloget shoqerues).

1. G20SR Jetegjatesia eshte 10.4 vjet per frekuencen 60 stimulime/min, 100% stimulim, 2.0V0.4 ms

2. Q20SR Jetegjatesia eshte 9,6 vjet per frekuencen 60 stimulime/min, 100% stimulim, 2.0V0.4 ms Sa me siper konfirmohet se jetegjatesia maksimale e ofruara per keto modele, per frekukencen e kerkuar (60 stimulime ne minut, ne 2.5 V, stimulin 100% dhe 0.4 ms gjeresi impulse) eshte jo me shume se 10.4 vjet. Pra del qarte qe asnje nga modelet e ofruara nuk ploteson specifikimet teknik te kerkuara, por ka nje diference te dukshme teknik 4 vjet me pak (ose 40% me te ulet qe specifikimet teknik te kerkuara. Ky devijim eshte devijim thelbesor, i cili ka efekt te dukshem ekonomik, pasi nje pacemaker i tille do te zevendesohet 4 vjet me pare se ai i kerkuar ne DST, pra rezulton ne efektin kohe rreth 40 % me i shtrenjte.”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, për Lotin 5, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika c dhe ç, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“c) Kërkohet deklarate e ofertuesit mbi origjinen e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) per secilin artikull; per plotësimin e afatit te skadences se tyre, si dhe respektimit te specifikimeve teknike te lotit/loteve qe oferton. Data e skadencës për materialet mjekësore objekt

prokurimi, në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

ç) Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohtet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, “Specifikimet teknike”, për Lotin 5, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Loti 5 - Pacemaker MRI compatible / Pacemaker të përshtatshëm për MRI:

Nr.	Materiale mjeksore	Njesia
	<i>Pacemaker MRI compatibel (Pacemaker te pershtateshem per MRI)</i>	
1*	<i>VVIR - FULL BODY MRI 1.5T pacemaker, storage of intracardiac electrograms, ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity, ëith programmable pacing polarity (unipolar and bipolar), impedance trend (graph of daily measured lead impedance vs. time), and automatic pacing polarity sëitch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead impedance is out of programmable range including bipolar lead, longevity of more than 14 years ëith 60 stimulations in minute at 2.5V 100% stimulation 0,4ms pulse ëidh.Compatible pacing lead ëith active or passive fixation ëith minimum introducer of 7F.Sheeth-introducer peel aëay for introducing permanent pacemaker electrode (including guide ëire, syringe, dilator, needle and introducer)of standard size from minimum 7 F. VVIR - stimulues kardiak , MRI kompatibel, full body 1.5T, ruajtja e elektrogrameve intrakardiake, me kalimin automatik të parametrave të tjerë në bazë të aktivitetit të pacientit, me programim te polaritetit te pejsimit (unipolar dhe bipolar), impedancën trendi (grafik i matjes së matjes së pjesshme të impedances ndaj kohës) dhe kalimi i polaritetit automatik të pejsimit nga bipolar në unipolar pacing në rast se impedanca e matur e plumbit është jashtë diapazonit të programueshëm duke përfshirë sonden bipolar, jetëgjatësinë e më shumë se 14 vjet me 60 stimulime në minutë në 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls.Sonda me Pejsim kompatibël me fiksion aktive ose pasive me hyrjen minimale të 7F.Sheath-peel aëëaypër futjen e elektrodës e pacemakerit (duke përfshirë tela udhëzues, shiringë, dilator, gjilpërë dhe futës) të madhësisë standarde nga minimumi 7F.</i>	cope
2*	<i>A fib FULL BODY MRI 1.5T dual chamber pacemaker, storage of intracardiac electrograms, ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity, automatic pacing polarity sëitch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead impedance is out of programmable range including bipolar lead, Algorithm for suppression atrial fibrillation by atrial pacing in sinus rhythm, automatic algorithm to prevent unnecessary ventricular</i>	cope

	<p><i>stimulation by adapting the AV delay, special frequency stimulation during mode changes (mode switch), storage of intracardiac electrograms in the device memory for 2 minutes with choice of priorities triggers, NIPS protocol, PVC Response, algorithm for terminating a PMT , longevity of more than 9 years with 60 stimulations in minute at 2.5V 100% stimulation 0,4ms pulse with with Stored EGM On.Compatible atrial and pacing lead with active or passive fixation with minimum introducer of 7F.DDDR stimulus karduak FULL BODY MRI 1.5T, stimulus me dy dhoma, ruajtja e elektrogrameve intrakardiacale, me kalimin automatik të parametrave të tjerë në bazë të aktivitetit të pacientit, kalimi automatik i pacing polaritetit nga bipolar në pacing unipolar në rast se impedanca e matur e plumbit është jashtë diapazonit të programueshëm duke përfshirë sonden bipolar, Algoritmi për fibrilimin atrial të shtypjes nga pacing atrial në ritmin e sinusit, algoritmi automatik për të parandaluar stimulimin e panevojshëm ventrikular duke përshtatur vonesën AV, stimulim të veçantë të frekuencës gjatë ndryshimeve të modalitetit (kaloni mode), ruajtjen e electrograms intracardiac në kujtesën e pajisjes për 2 minuta me zgjedhjen e prioriteteve shkakton, NIPS protokoll, PVC Përgjigje, algoritmi për ndërprerjen e një PMT, jetëgjatësi më shumë se 9 vjet me 60 stimulime në minutë me 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls me EGM të ruajtura On.Compatible e atriale dhe pacing plumbi me fiksion aktiv ose pasiv me hyrjen minimale të 7F</i></p>	
3	<p><i>Pacing system analyser (PSA) restiriliable patients cable compatible with programer (Kabell i rresterilizueshem qe lidhet me programatorin dhe sherben si analizator per matjet gjate implantimit te pacemakerit</i></p>	<i>cope</i>
4	<p><i>Paper for programer (leter per programatorin)</i></p>	<i>cope</i>
5	<p><i>Disposable large alligator clip style extension with safe connect used for temporary pacing procedures/resterilized) (Kabell me 2 dalje me krokodila qe lidhet me pacemakerin e jashtem/I sterilizueshem)</i></p>	<i>cope</i>

Shënim: Për artikujt e mësipërm (lotit 5) me nr. 1 dhe 2, TVSH-ja është e përjashtuar pasi janë materiale të implantueshme (Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 51).

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PERGJITHESHME:

- Afati i Skadences: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.
- Kerkohet autodeklarate për materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC ose 98/79/EC ose 2015/1535/EU, dhe ISO 9001 ose EN ISO 13485, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese CE/DC (Deklarate konformiteti) kur eshte e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes, origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e dorezimit.
- Autorizim nga MAH / prodhuesi ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi.

- Katalogje origjinale ose të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe për të gjithë artikujt dhe të markohen artikujt që ofrohen.
- Për artikujt e mësipërm me shenjën asterisko (*) tek numri, duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave
- Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull.

III.1.3. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, për Lotin 5, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Loti 5 - Pacemaker MRI compatible / Pacemaker të përshatshëm për MRI:

Nr.	Materiale mjeksore	Njesia	Sasia
	<i>Pacemaker MRI compatibel (Pacemaker te pershtateshem per MRI)</i>		
1*	<i>VVIR - FULL BODY MRI 1.5T pacemaker, storage of intracardiac electrograms, ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity, ëith programmable pacing polarity (unipolar and bipolar), impedance trend (graph of daily measured lead impedance vs. time), and automatic pacing polarity sëitch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead impedance is out of programmable range including bipolar lead, longevity of more than 14 years ëith 60 stimulations in minute at 2.5V 100% stimulation 0,4ms pulse ëidh.Compatible pacing lead ëith active or passive fixation ëith minimum introducer of 7F.Sheeth-introducer peel aëay for introducing permanent pacemaker electrode (including guide ëire, syringe, dilator, needle and introducer)of standard size from minimum 7 F. VVIR - stimulues kardiak , MRI kompatibel, full body 1.5T, ruajtja e elektrogrameve intrakardiake, me kalimin automatik të parametrave të tjerë në bazë të aktivitetit të pacientit, me programim te polaritetit te pejsimit (unipolar dhe bipolar), impedancën trendi (grafik i matjes së matjes së pjesshme të impedances ndaj kohës) dhe kalimi i polaritetit automatik të pejsimit nga bipolar në unipolar pacing në rast se impedanca e matur e plumbit është jashtë diapazonit të programueshëm duke përfshirë sonden bipolar, jetëgjatësinë e më shumë se 14 vjet me 60 stimulime në minutë në 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls.Sonda me Pejsim kompatibël me fiksime aktive ose pasive me hyrjen minimale të 7F.Sheath-peel aëaypër futjen e elektrodës e pacemakerit (duke përfshirë tela udhëzues, shiringë, dilator, gjilpërë dhe futës) të madhësisë standarde nga minimumi 7F.</i>	cope	25
2*	<i>A fib FULL BODY MRI 1.5T dual chamber pacemaker, storage of intracardiac electrograms, ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity, automatic pacing polarity sëitch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead</i>	cope	15

	<i>impedance is out of programmable range including bipolar lead, Algorithm for suppression atrial fibrillation by atrial pacing in sinus rhythm, automatic algorithm to prevent unnecessary ventricular stimulation by adapting the AV delay, special frequency stimulation during mode changes (mode switch), storage of intracardiac electrograms in the device memory for 2 minutes with choice of priorities triggers, NIPS protocol, PVC Response, algorithm for terminating a PMT, longevity of more than 9 years with 60 stimulations in minute at 2.5V 100% stimulation 0,4ms pulse with with Stored EGM On.Compatible atrial and pacing lead with active or passive fixation with minimum introducer of 7F.DDDR stimulus karduak FULL BODY MRI 1.5T, stimulus me dy dhoma, ruajtja e elektrogrameve intrakardiacale, me kalimin automatik të parametrave të tjerë në bazë të aktivitetit të pacientit, kalimi automatik i pacing polaritetit nga bipolar në pacing unipolar në rast se impedanca e matur e plumbit është jashtë diapazonit të programueshëm duke përfshirë sonden bipolar, Algoritmi për fibrilimin atrial të shtypjes nga pacing atrial në ritmin e sinusit, algoritmi automatik për të parandaluar stimulimin e panevojshëm ventrikular duke përshtatur vonesën AV, stimulim të veçantë të frekuencës gjatë ndryshimeve të modalitetit (kaloni mode), ruajtjen e electrograms intracardiac në kujtesën e pajisjes për 2 minuta me zgjedhjen e prioriteteve shkakton, NIPS protokoll, PVC Përgjigje, algorithm për ndërprerjen e një PMT, jetëgjatësi më shumë se 9 vjet me 60 stimule në minutë me 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls me EGM të ruajtura On.Compatibl e atriale dhe pacing plumbi me fiksion aktiv ose pasiv me hyrjen minimale të 7F</i>		
3	<i>Pacing system analyser (PSA) restirizable patients cable compatible with programmer (Kabell i rsterilizueshem qe lidhet me programatorin dhe sherben si analizator per matjet gjate implantimit te pacemakerit</i>	<i>cope</i>	<i>10</i>
4	<i>Paper for programmer (leter per programatorin)</i>	<i>cope</i>	<i>10</i>
5	<i>Disposable large alligator clip style extension with safe connect used for temporary pacing procedures/resterilized) (Kabell me 2 dalje me krokodila qe lidhet me pacemakerin e jashtem/I sterilizueshem)</i>	<i>cope</i>	<i>8</i>

Kontratat do te jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me OE te shpallur fitues, me afat perfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

Afatet e lëvrimit: QSUT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 mujor. Perjashtimisht ketij percaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhi kontratë për çdo nevojë për materiale mjekesore që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në cdo kohë. Për çdo kontratë të lidhur sipas percaktimit më sipër afatet e lëvrimit do të jenë si më poshtë: 15% e mallit për secilin material duhet të lëvrohet maksimumi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave të Shërbimit të Hemodinamikës dhe Drejtorisë së Shërbimit Farmaceutik.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.
- Ofertë Teknike e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., në të cilën pasqyrohen Materialet mjekësore objekt prokurimi; Kompania prodhuese; Origjina e mallit; Skadencia; Emërtimi i Katalogu; Numri i referencës (kodi); Certifikimet.
- Dokumentin “Katalogët origjinale të markuar” Vitatron – The Pace Makers.
- Dokumentin “Katalogë të përkthyer” Vitatron – The Pace Makers.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.6. Në nenin 27, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konkretisht për Pacemaker MRI Compatibel VVIR – Full Body MRI 1.5 T, në specifikimet teknike, ndër të tjera ka kërkuar që ky produkt të ketë “jetëgjatësi më shumë se 14 vjet me 60 stimulime në minutë në 2.5V stimuli m 100% 0,4 ms gjerësi impuls”. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin katalogët për pajisjet mjekësore, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen

specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përpuethshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këto pajisje.

III.1.8. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, Katalogët e produkteve të ofruara, të përkthyer dhe të noterizuar, dokumentin “Ofertë Teknike” në të cilën pasqyrohen Materialet mjekësore objekt prokurimi si dhe informacionet në lidhje me to për sa i përket Kompanisë prodhuese; Origjinës së mallit; Skadencës së tyre; Emërtimi në Katalog; Numri i referencës (kodi); si dhe Certifikimet.

Konkretisht, operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., për produktin “*VVIR - FULL BODY MRI 1.5T pacemaker, storage of intracardiac electrograms, ëith automatic sëitching to the rest (sleep) parameters based on the patient activity, ëith programmable pacing polarity (unipolar and bipolar), impedance trend (graph of daily measured lead impedance vs. time), and automatic pacing polarity sëitch from bipolar to unipolar pacing in case that measured lead impedance is out of programmable range including bipolar lead, longevity of more than 14 years ëith 60 stimulations in minute at 2.5V 100% stimulation 0,4ms pulse ëidth.Compatible pacing lead ëith active or passive fixation ëith minimum introducer of 7F.Sheeth-introducer peel aëay for introducing permanent pacemaker electrode (including guide ëire, syringe, dilator, needle and introducer)of standard size from minimum 7 F. VVIR - stimulues kardiak , MRI kompatibel, full body 1.5T, ruajtja e elektrogrameve intrakardiake, me kalimin automatik të parametrave të tjerë në bazë të aktivitetit të pacientit, me programim te polaritetit te pejsimit (unipolar dhe bipolar), impedancën trendi (grafik i matjes së matjes së pjesshme të impedances ndaj kohës) dhe kalimi i polaritetit automatik të pejsimit nga bipolar në unipolar pacing në rast se impedanca e matur e plumbit është jashtë diapazonit të programueshëm duke përfshirë sonden bipolar, jetëgjatësinë e më shumë se 14 vjet me 60 stimulime në minutë në 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls.Sonda me Pejsim kompatibel me fiksime aktive ose pasive me hyrjen minimale të 7F.Sheath-peel aëëaypër futjen e elektrodës e pacemakerit (duke përfshirë tela udhëzues, shiringë, dilator, gjilpërë dhe futës) të madhësisë standarde nga minimumi 7F.*”, referuar deklaratës së tij në ofertën teknike, konstatohet se ka paraqitur Katalogun origjinal dhe të përkthyer të firmës Vitatron, duke markuar artikullin 1 sipas modelit G20A2, së bashku me specifikimet teknike, në të cilin konstatohet se jetëgjatësia e këtij modeli për 60 stimulime në minutë në 2.5V stimulim 100% 0,4ms gjerësi impuls është 9.6 vite për 500 Ω dhe 10.4 vite për 1000 Ω. Pra, sa më sipërm KPP konstaton se, ky model i ofruar nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k. nuk përmbush të gjitha specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, në lidhje me jetëgjatësinë e produktit, ku konkretisht është kërkuar që për 60 stimulime në minutë në 2.5V stimulim 100 % 0,4ms gjerësi impulse, jetëgjatësia e produktit të jetë më shumë se 14 vjet.

Sa më sipër argumentuar, konstatojmë se, specifikimet teknike të produktit “*VVIR - FULL BODY MRI 1.5T pacemaker*”, Model Vitatron G20A2, të paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin “*VVIR - FULL BODY MRI 1.5T pacemaker*”, duke mos plotësuar kështu kërkesat e autoritetit kontraktor.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

III.1.9. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” sh.p.k., për skualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” sh.p.k. mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-30190-07-12-2019, me objekt: “Blerje materiale mjekësore specifike për Shërbimin e Hemodinamikës në QSUT” Loti 5 “Pacemaker MRI compatible/Pacemaker të përshtatshëm për MRI”, me fond limit 8.843.138,34 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1600 Protokolli

Datë 09.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha